01/539/26
08-4-2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KOSOVSKA KATASTARSKA AGENCIJA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Prishtinë
Nr. 24/26
08.04.2026

Në mbështetje të Nenit 23 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, dhe nenit 33 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme, Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet komisioni për shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve të Zyrave Kadastrale Komunale apo Agjencisë Kadastrale të Kosovës, sipas dispozitave të Ligjit Nr. 08-237 për Kadastër të Pronës Paluajtshme, në këtë përbërje:
   1.1. Demir Hyseni – Ekspert për Kadastër & GIS, kryetar;
   1.2. Bashkim Shaqiri – Udhëheqës i Divizionit për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit anëtar, dhe
   1.3. Mentor Kasumi – ud. Udhëheqës i Divizionit për Matje dhe Rrjeta Gjeodezike, anëtar.

2. Shfuqizohet Vendimi me nr.63/25 i datës 21.07.2026 me numër protokoli 01/1356/25,

3. Anëtarët e komisionit për shqyrtim të ankesave zgjidhen me mandat një (1) vjeçar,

4. Në rast të pamundësisë së ushtrimit të detyrës nga kryetari, të njejtin e zëvendëson njëri nga anëtarët e komisionit të cilin e cakton kryetari,

5. Anëtarë të komisionit për shqyrtim të ankesave të cekura në pikën 1 të këtij vendimi janë zyrtarë që ushtrojnë detyra profesionale në kuadër të Departamenteve përkatëse që puna, përvoja dhe profesioni i tyre ndërlidhet me njohurit e kërkuara të fushës së kadastrit dhe asaj juridike,

6. Komisioni obligohet të veproj në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi,

Adresa: Agjencia Kadastrale e Kosovës Rr. "Arbënor e Astrit Dehari" Nr. 25,
10 000 Prishtinë. Tel: + 383 (0) 38 512-353

7. Puna dhe procedura e komisionit për shqyrtimin e ankesave bazohet në rregullat e përcaktuara për organet kolegjiale të parapara në Pjesen II, Kapitullin II, Nënkapitullin VI të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative,

8. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për shqyrtim të ankesave janë:

   8.1. Pranimi, shqyrtimi dhe vendosja e ankesave kundër vendimeve të zyrave kadastrale komunale apo Agjencisë Kadastrale të Kosovës, sipas dispozitave të Ligjit Nr. 08-237 për Kadastër të Pronës Paluajtshme;
   8.2. Mbajtja e regjistrit të lëndëve të pranimit dhe shqyrtimit të ankesave;
   8.3. Pjesëmarrja e anëtarëve të komisionit për shqyrtim të ankesave në mbledhje në formë fizike apo elektronike;
   8.4. Shqyrtimi dhe vlerësimi i komenteve dhe opinioneve të marra nga zyrtarët e fushave përkatëse;
   8.5. Komisioni për shqyrtimin e ankesave:

      8.5.1. Mban procesverbal për shqyrtimin e ankesave;
      8.5.2. Varësisht nga natyra e lëndës, cakton zyrtarin përgjegjës për përgatitje të vendimit;
      8.5.3. I dërgon zyrtarit përgjegjës për përgatitje të vendimit procesverbalin e shqyrtimit të ankesës dhe
      8.5.4. Mban regjistër për lëndët e caktuara zyrtarëve përgjegjës.

   8.6. Nënshkrimi i Vendimit dhe Procesverbalit të vendimmarrjes dhe takimeve dhe

   8.7. Kryerja e punëve të tjera në lidhje me procesin e shqyrtimit të ankesave dhe vendimmarrjes.

9. Komisioni për shqyrtimin e ankesave kryen detyrat në mënyrë objektive dhe u shmanget situatave që përbëjnë konflikt interesi në përputhje me ligjin përkatës për parandalimin e konfliktit të interesit,

10. Komisioni për shqyrtimin e ankesave i raporton Drejtorit Ekzekutiv të AKK-së apo të deleguarve të tij, rreth mbarëvajtjes së procesit, çdo muaj apo në çdo kohë me kërkesë të Drejtorit Ekzekutiv të AKK-së dhe të deleguarve të tij,

11. Ky vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga ud. Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Arsyetim

Në bazë të aktemërimit me numër protokoli 045/2026 të datës 26.03.2026, ish-kryesuesja Edona Kutllovci Durmishi është transferuar me punë në Zyrën e Kryeministrit (ZKM). Me largimin e saj, vendimi i mëparshëm shfuqizohet dhe ajo zëvendësohet me Demir Hysenin si kryesues.

Njëkohësisht, anëtari i Komisionit Faik Kelmendi, është caktuar Ushtrues i detyrës së Drejtorit Ekzekutiv në Agjencinë Kadastrale të Kosovës në bazë të vendimit me nr. protokoli 1392/26 të datës 25.03.2026. Me kalimin në këtë detyrë ekzekutive, ai zëvendësohet me Bashkim Shaqirin si anëtar.

Adresa: Agjencia Kadastrale e Kosovës Rr. "Arbënor e Astrit Dehari" Nr. 25,
10 000 Prishtinë. Tel: + 383 (0) 38 512-353

Poashtu anëtari tjetër i komisionit Naim Nishori, ka njoftuar Drejtorin Ekzekutiv duke shprehur dëshirën për të mos qenë më pjesë e komisionit për arsye personale. Në vend të tij emërohet anëtari Mentor Kasumi, për të mbështetur objektivitetin dhe efikasitetin e punës të Komisionit për shqyrtimin e ankesave sipas ligjeve në fuqi.

Këto zëvendësime bazohen në nevojën për të mbajtur komisionin funksional pa vonesa, duke respektuar mandatin njëvjeçar bazuar në Ligjin Nr.08/L-237 për Kadastër të pronës së paluajtshme neni 33 paragrafi 7, e cekur në pikën 3 të këtij dispozitivi. Kjo u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:
1. **Antarëve të komisionit,**
2. **Arkivit të AKK-së.**

ud. Drejtor Ekzekutiv në AKK
Faik Kelmendi

Insajderi
Gazetë online

Adresa: Agjencia Kadastrale e Kosovës Rr. "Arbënor e Astrit Dehari" Nr. 25.
10 000 Prishtinë. Tel: + 383 (0) 38 512-353